




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D / DPK	Nr Prot Br Prot Prot No 01-2103/2012
Nr. i tau Broj stranica Nr. pages 02	Dati Datum Dati 13.06.2012



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.06.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-5101/11, për Zyrtarin e Lartë, z.Mentor Hoxhaj, Zëvendës. Mbikëqyrës Kryesor Shtetërorë në Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e te Dhënave Personale, për shkak se Zyrtari i Lartë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e parapare sipas nenit 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës se marre gjate kontrollit të formularit për deklarim të pasurisë, ka filluar shqyrtimi i lendes me numër protokolli AKK-03-5101/11, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z.Mentor Hoxhaj z.v Mbikëqyrës Kryesor Shtetërorë - Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e te Dhënave Personale.

Gjate zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari e lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si zëvendës. Mbikëqyrës Kryesor Shtetërorë në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e te Dhënave Personale ka qene i regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve ARBK, si Pronar dhe person i autorizuar në biznesin Individual "Radio Taxi- Toni"-Gjakovë si dhe në Biznesin tjetër "Blue Bare" Prishtinë, e që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 06.03.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë

me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Mentor Hoxhaj zëvendës mbikëqyrës Kryesor Shtetërorë, pasi ka kontaktuar me zyrtaret e Agjencisë ka kërkuar të ballafaqohet me faktet që posedon Agjencia.

Me datën 20.03.2012 është mbajtur takimi me z. Mentor Hoxhaj, gjatë takimit që është mbajtur në zyrat e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është biseduar për gjendjen dhe faktet që disponon Agjencia lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit.

Zyrtari i Lartë, z. Mentor Hoxhaj gjatë takimit është pajtuar për situatën mirëpo është arsyetuar se nuk ka qenë informuar për këtë, pasi që nuk e ka informuar as kush që nga momenti i zgjedhjes si, zëvendës mbikëqyrës Kryesor Shtetërorë dhe në bizneset që është Pronare dhe person i autorizuar nuk funksionojnë por vetëm kanë mbetur të regjistruara në ARBK, për shkak të mos azhurnimit të të dhënave, dhe nuk ka pas njohuri për këtë situatë që mundë të shkaktoj konflikt të mundshëm të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik.

z. Mentor Hoxhaj, z.v Mbikëqyrës Kryesor Shtetërorë në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është zotuar se në afatin ligjor do të bëjë ndryshimet në këto biznese dhe do ta bëjë shmangien konfliktit të mundshëm të interesit.

Me datën 24.05.2012, Zyrtari i Lartë z. Mentor Hoxhaj ka sjellë dëshminë nga (ARBK-ja), se i ka bërë ndryshimet e kërkuar dhe ka autorizuar një person tjetër në pozitën e personat të autorizuar në bizneset e lartcekura "Radio Taxi- Toni" në Gjakovë si dhe në Biznesin tjetër "Blue Bare" në Prishtinë.

Andaj në bazë të dëshmive dhe të dhënave të sjella nga zyrtari i lartë z. Mentor Hoxhaj, z.v Mbikëqyrës Kryesor Shtetërorë në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, konstatojmë se z. Mentor Hoxhaj, ka shmangur gjendjen e mundshme të Konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej pasi që nuk mbanë me pozitë udhëheqëse në bizneset private ku kishte funksion menagjierial, kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri me funksionin publik si z.v. Mbikëqyrës Kryesor Shtetërorë në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

